



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PLANI STRATEGJIK 2026-2028

Shkup, janar 2026



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Të nderuar,

Me kënaqësi ju prezantojmë Planin Strategjik të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit për periudhën 2026–2028. Ky dokument paraqet vizionin për arsim dhe edukim cilësor dhe vendos bazat për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Qëllimi ynë është rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në funksionimin e përgjithshëm të Byrosë, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së sistemit arsimor, si themel për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe moderne. Përparësi strategjike mbetet krijimi i kushteve dhe mundësive për zhvillimin e kompetencave të nxënësve, me qëllim përgatitjen e tyre për përballimin e suksesshëm të sfidave të përditshme shoqërore dhe të tregut të punës.

Në funksion të rritjes së efikasitetit të punës sonë, janë identifikuar përparësi dhe objektiva strategjike, të shoqëruara me aktivitete dhe indikatorë të qartë, të cilët do të shërbejnë si bazë për monitorimin dhe matjen e progresit. Kjo qasje siguron përgjegjësi institucionale dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit, duke u bazuar në bindjen se arsimi përbën faktor kryesor për zhvillimin e vendit dhe për integrimin në proceset evropiane.

Mësimdhënia cilësore dhe angazhimi profesional i mësimdhënësve janë elemente thelbësore për arritjen e rezultateve optimale në sistemin arsimor. Krahas procesit të mësimdhënies, një nga sfidat kryesore mbetet rritja e motivimit të mësimdhënësve, të cilët kanë rol vendimtar në formimin e brezave të rinj.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Zhvillimi i sistemit të arsimit dhe edukimit do të realizohet përmes monitorimit, sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë, si dhe përmes zbatimit të veprimtarive zhvillimore, këshillimore, kërkimore dhe të tjera profesionale në arsimin dhe edukimin parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Ky Plan Strategjik është rezultat i punës së përbashkët të të gjithë të punësuarve në Byro, si dhe i bashkëpunimit të frytshëm me partnerët tanë dhe të gjitha palët e interesuara. Në këtë drejtim, ju uroj zbatim të suksesshëm të vizionit tonë të përbashkët dhe ju falënderoj për përkushtimin tuaj.

Nr.01-67/1
13.01.2026
Shkup

Me respekt,

Mr. Millka Trimçevska
Drejtore



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

PËRMBAJTJA

TERMINOLOGJIA	5
1.1. HYRJE	6
1.2. ANALIZA E GJENDJES	7
1.2.1. HISTORIKU I BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT	7
1.2.2. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE	9
1.2.2.1. ANALIZA SWOT	10
1.2.2.2. ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE	12
1.2.2.3. PËRCAKTIMI I PALËVE TË INTERESUARA	14
1.2.2.4. INFRASTRUKTURA E DISPONUESHME	14
1.2.2.5. BURIMET FINANCIARE	14
1.2.2.6. BURIMET NJERËZORE	15
1.2.2.7. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA	15
1.3. MISONI	17
1.4. VIZIONI	17
1.5. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT	18
1.6. VEÇORITË E BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT	18
1.7. STRUKTURA E BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT	19
1.8. MARRËDHËNIET ME ORGANET NË PËRBËRJE	25
1.9. PËRPARËSITË DHE OBJEKTIVAT E BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT	25
1.10. PASQYRË E REZULTATEVE TË ARRITURA NË VITIN 2023	27
1.11. PASQYRË E REZULTATEVE TË ARRITURA NË VITIN 2024	29
2. PROGRAMET	33
2.1. PLANI PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT: ARSIM PARASHKOLLOR, FILLOR DHE TË MESËM CILËSOR	33
3. NDIKIMI NË BURIMET NJERËZORE	65
4. PARIMET E PËRFAQËSIMIT TË DREJTË	66
5. PARIMI I MUNDËSIVE TË BARABARTA PËR GRATË DHE BURRAT	66
6. ZHVILLIMI I FUNKSIONEVE TË PËRBASHKËTA	68
7. RREZIQET NË NIVEL TË PLANIT STRATEGJIK	74
7.1. RREZIQET NË NIVEL TË PROGRAMIT 1	75



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

TERMINOLOGJIA

AA –	Agjencia e Administratës
AZGJ –	Agjencia e Zbatimit të Gjuhëve
BZHA –	Byroja e Zhvillimit të Arsimit
QRMV –	Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
QSHP–	Qendra Shtetërore e Provimeve
ISHA –	Inspektorati Shtetëror i Arsimit
BE –	Bashkimi Evropian
MPA –	Ministria e Administratës Publike
MASH –	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MSPDR –	Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve
MF –	Ministria e Financave
PKPBE – Programi Kombëtar për Përshtatjen e Legjislacionit me	Bashkimin Evropian
UKM –	Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi“
QZHAP –	Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional
ACQUIS –	Legjislacion i akumuluar, akte juridike dhe
vendime	gjyqësore që përbëjnë trupin e së drejtës së Bashkimit Evropian



1.1. HYRJE

Plani strategjik i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit (në tekstin e mëtejme: Byroja), organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me status të personit juridik, është përgatitur për periudhën 2026–2028 dhe paraqet dokumentin kryesor strategjik të planifikimit për zhvillim, i cili bazohet në një analizë të mëparshme gjithëpërfshirëse të gjendjes në fushën e veprimit të institucionit.

Analiza e gjendjes, përkatësisht përcaktimi i gjendjes fillestare, si një nga instrumentet për krijimin e politikave, si proces ndihmoi që në mënyrë individuale dhe grupe të ndërtohet një kuptim i përbashkët i problemeve me rëndësi prioritare, por njëkohësisht edhe të analizohen faktorët kryesor, zhvillimet dhe trendet në fushën e veprimtarisë dhe punës sonë. Në këtë mënyrë janë përcaktuar prioritetet dhe objektivat strategjike për periudhën e ardhshme të Byrosë, në përputhje me prioritetet dhe objektivat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Gjatë përgatitjes së Planit strategjik janë marrë parasysh udhëzimet e përcaktuara me Metodologjinë për planifikim strategjik dhe përgatitjen e Programit vjetor të punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 124/08 dhe 58/18), Udhëzimin për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e përgatitjes së planit strategjik dhe planit vjetor të punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 131/18), si dhe Udhëzimin për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e ndjekjes, vlerësimit dhe raportimit të planit strategjik dhe planit vjetor të punës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 131/18).



1.2. ANALIZA E GJENDJES

1.2.1. HISTORIKU I BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Hapi i parë për themelimin e një instituti për avancimin e arsimit dhe edukimit është bërë në verën e vitit 1955. Më saktësisht, më 11 gusht 1955, me Vendim të Këshillit Ekzekutiv të RP të Maqedonisë, nr. 214 (për shkak të fillimit të përgatitjeve për reformën e arsimit në territorin e RSF të Jugosllavisë), u themelua Instituti për Avancimin dhe Studimin e Shkollimit, për kryerjen e shërbimit arsimor-pedagogjik në RP të Maqedonisë.

Instituti filloi punën më 1 janar 1956. Kompetenca e tij kryesore ishte përgatitja e materialeve për reformën e arsimit. Këshilli për Arsim i RP të Maqedonisë e kuptoi se nuk është e mundur të bëhen reforma në arsim pa përgatitje solide të mësuesve dhe pa aftësimin e tyre të vazhdueshëm për përmbushjen e një detyre kaq të ndërlikuar dhe me rëndësi të madhe shoqërore.

Punonjësit profesionalë në Institut kishin kompetencë të merrnin pjesë në procesin mësimor, të kujdeseshin për përmbajtjen mësimore, për vlerësimin e saj dhe të përcillnin njohuritë teorike në praktikën mësimore. Që nga fillimi i kësaj veprimtarie, Instituti jepte mendime dhe propozime për përpilimin e planeve dhe programeve mësimore dhe kujdesej vazhdimisht për zbatimin e tyre në shkolla. Për realizimin e këtyre qëllimeve komplekse u krijuan ekipe profesionale që zbatonin ndryshimet në shkolla, propozonin masa për përgatitjen profesionale të kuadrit mësimor, studionin dhe jepnin propozime për rinovimin e objekteve ekzistuese shkollore dhe për ndërtimin e objekteve të reja shkollore.

Themelimi i institutit të parë përkon me fillimin e përgatitjeve themelore dhe intensifikimin e aktiviteteve për reformën e parë të arsimit në vitin 1958. Kështu, kjo shërbim e filloi veprimtarinë e saj si organ administrativ në kuadër të Këshillit për Arsim të RPM-së. Në vitin 1960, nga nevoja për zhvillimin dhe orientimin e saj drejt një institucioni të pavarur që do të propozonte masa për përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha institucionet arsimore, u miratua Ligji për shërbimin arsimor-pedagogjik të RPM-së ("Gazeta Zyrtare e RPM-së", nr. 16/60). Me këtë ligj u rregullua veprimtaria e përgjithshme e Institutit Republikan për Avancimin e Shkollimit, ndërsa u formuan edhe institute rajonale në Ohër, Manastir, Prilep, Kavadar, Titov Veles, Tetovë, Berovë, Strumicë, Gostivar dhe Kumanovë.

Institutet e asaj periudhe funksiononin si institucione të pavarura, por brenda organeve të administratës.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Një transformim më i rëndësishëm i shërbimit arsimor-pedagogjik ndodhi me Ligjin për organizimin e veprimtarisë për avancimin e arsimit dhe edukimit të vitit 1974 (“Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 17/74), i cili krijoi bazë ligjore për organizimin e një shërbimi cilësor arsimor-pedagogjik, i ngarkuar me analizimin dhe studimin e praktikës pedagogjike të mësuesve dhe shkollave në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë. Me këtë ligj, duke marrë parasysh detyrat dhe funksionin e tyre, institutet ekzistuese të shkollimit u transformuan nga organe të administratës në institute për avancimin e arsimit dhe edukimit.

Bazuar në rezultatet e arritura, periudha nga 1974 deri në vitet nëntëdhjetë (me miratimin e Ligjit për organet e administratës më 28 shtator 1990) me të drejtë mund të shënohet si kohë në të cilën kompetenca profesionale e institutit erdhi më shumë në shprehje. Në periudhën pas vitit 1990, institutet për avancimin e arsimit kaluan nëpër fazën më të vështirë të zhvillimit të tyre.

Me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 40/1990) u bashkuan të gjitha institutet komunale dhe ndërkomunale, si dhe Instituti Republikan për Avancimin e Arsimit, në një institucion të vetëm dhe u formua Instituti Pedagogjik i Maqedonisë.

Me këtë transformim u harmonizua zhvillimi i veprimtarisë për avancimin e arsimit në arsimin parauniversitar në Republikën e Maqedonisë.

Megjithatë, ndryshime edhe më të thella dolën nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore të vitit 2000 (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 58/2000), kur Instituti Pedagogjik i Maqedonisë vazhdoi të funksionojë si Byro e Zhvillimit të Arsimit, organ në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me status të personit juridik, si bartës i të gjitha reformave të rëndësishme në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

1.2.2. ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Byroja e Zhvillimit të Arsimit, si organ në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me status të personit juridik, kryen punë profesionale me rëndësi për zhvillimin dhe avancimin e edukimit dhe arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Prioritetet dhe objektivat e përcaktuara në Planin Strategjik për periudhën 2026–2028 bazohen në rezultatet e analizës së punës së Byrosë, ndërsa aktivitetet e parashikuara në planin strategjik do të jenë obligim i të gjithë të punësuarve për të arritur treguesit e vendosur të suksesit.

Para përcaktimit të përparësive strategjike dhe objektivave me përparësi për periudhën e ardhshme trevjeçare dhe planeve për të ardhmen, u ndërmor përgatitja e një analize cilësore të faktorëve kryesor, kushteve, rrethanave, trendeve bashkëkohore dhe zhvillimeve në fushën e kompetencave të Byrosë, në përputhje me misionin e përcaktuar. Në këtë proces u udhëhoq nga nevoja për përputhshmëri dhe harmonizim me prioritetet dhe objektivat strategjike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përmes analizës së gjendjes ekzistuese u synua të gjendet përgjigje për disa pyetje kryesore: ku ndodhemi si Byro në kontekstin e fushës së veprimtarisë sonë, cila është gjendja në këtë fushë, cilat janë problemet kryesore me përpraësi, cila është natyra dhe ndikimi i tyre, pse është e rëndësishme zgjidhja me përparësi e problemit ose problemeve dhe cilat janë palët e interesuara të prekura nga këto probleme.

Me rëndësi kryesore ishte identifikimi dhe përzgjedhja e çështjeve me përparësi që e prekin Byronë dhe arritja e një qëndrimi të përbashkët në lidhje me çështjet dhe objektivat kritike, përkatësisht prioritare.

Gjithashtu, u bë një analizë e burimeve dhe kapaciteteve financiare dhe njerëzore në dispozicion; u përcaktuan kapacitetet që duhet të përmirësohen ose të forcohen; si dhe u identifikuan rreziqet nga mjedisi i brendshëm dhe i jashtëm që mund të rrezikojnë ose të vështirësojnë realizimin e rezultateve të planifikuara. Njëkohësisht u identifikuan pikat e forta dhe mundësitë/sfidat që janë në dispozicion dhe që duhet të shfrytëzohen.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

1.2.2.1. ANALIZA SWOT

Në nivel të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit u përgatit një analizë SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats), si instrument për analizën e gjendjes në institucion, me të cilën u përcaktuan përparësitë dhe dobësitë, si dhe u identifikuan mundësitë dhe kërcënimet me interes për funksionimin e suksesshëm të mëtejshëm të Byrosë.

Kjo analizë mundësoi skanimin e gjendjeve të brendshme, përkatësisht përcaktimin e të gjitha elementeve të rëndësishme në funksionimin e Byrosë, përfaqësimin e interesave të të gjitha njësive organizative, si dhe faktorët nga mjedisi i jashtëm.

Përgatitja e analizës kontribuon në realizimin e qëllimeve të mëposhtme:

- implementimi i analizës funksionale në drejtim të forcimit të kapaciteteve;
- rritja e nivelit të funksionalitetit dhe efikasitetit të Byrosë;
- identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve;
- vendosja e një sistemi adekuat për zbatimin e politikave përkatëse dhe koordinimin/komunikimin;
- forcimi i kapaciteteve institucionale në drejtim të zhvillimit dhe avancimit të edukimit dhe arsimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- përcaktimi i drejtimeve të planifikimit strategjik, monitorimit të zbatimit dhe vlerësimit;
- forcimi dhe konkretizimi i bashkëpunimit institucional me palët e interesuara;
- vendosja e një sistemi adekuat për përmirësimin e vazhdueshëm profesional të të punësuarve në Byronë.



Tabelë: Analiza SWOT

PËRPARËSI	DOBËSI
<ul style="list-style-type: none">• Përvojë dhe histori e pasur• Cilësi e lartë e punës së të punësuarve• Rezultate të mira të arritura• Strukturë e përshtatshme organizative• Ndjekja e zhvillimit teknologjik dhe trendeve• Gjithpërfshirje (inkluzion)	<ul style="list-style-type: none">• Mungesë e burimeve njerëzore• Mungesë e kushteve materiale për punë• Teknologji e vjetëruar e TIK• Kufizime në zhvillimin e karrierës• Mungesë e hapësirave në pronësi
<ul style="list-style-type: none">• Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira me institucione të ngjashme dhe të afërta në rajon dhe në BE• Forcimi i kapaciteteve dhe aftësive të të punësuarve• Rritja e numrit të të punësuarve• Përmirësimi i kushteve të punës• Përmirësimi i perceptimit për institucionin• Zgjidhja e marrëdhënieve pronësore-juridike	<ul style="list-style-type: none">• Largimi i kuadrit profesional• Ndryshime ekonomike (mjete financiare të pamjaftueshme) për institucionin• Konkurrencë e pamjaftueshme ndërmjet operatorëve ekonomikë• Rezistencë ndaj risive• Ndryshime në mjedisin politik• Ndryshime të shpeshta në legjislacion dhe mosharmonizim ndërmjet dispozitave ligjore



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

1.2.2.2. ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE

Gjatë përcaktimit të përparësive dhe objektivave, Byroja e Zhvillimit të Arsimit u udhëhoq nga këto parime:

- lidhja e misionit të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit me prioritetet dhe objektivat strategjike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dhe rrjedhimisht edhe me prioritetet dhe objektivat strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2024–2028 (Vendimi për ndryshimin e vendimit për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2024–2028 (“Gazeta Zyrtare e RMV”, nr. 177, datë 26.8.2024), nga Metodologjia për planifikim strategjik dhe përgatitjen e Programit Vjetor të punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, prioritetet dhe objektivat në Programin Kombëtar për miratimin e së drejtës së BE-së, si dhe Strategjia për zhvillimin e arsimit 2018–2025;
- harmonizimi i prioriteteve dhe objektivave të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit me prioritetet dhe objektivat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
- realizueshmëria reale e prioriteteve dhe objektivave të përcaktuara, në përputhje me burimet dhe kapacitetet reale në dispozicion të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit;
- matshmëria e rezultateve përmes një grupi të balancuar dhe relevant të treguesve të suksesit.

Plani strategjik i Byrosë bazohet në:

- Programin e punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut 2024–2028;
- Programin e punës së Qeverisë për vitin 2025;
- Vendimin për ndryshimin e vendimit për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2024–2028;
- Programin Kombëtar për Miratimin e së Drejtës së BE-së 2021–2025 (NPAA);
- Ligjin për Byronë për Zhvillimin e Arsimit;
- Ligjin për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve;
- Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve;
- Ligjin për arsimin fillor;
- Ligjin për arsimin e mesëm;
- Ligjin për arsimin dhe aftësimin profesional;
- Ligjin për arsimin e të rriturve;



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

- Ligjin për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme;
- Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve;
- Ligjin për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm;
- Ligjin për shërbimin pedagogjik;
- Ligjin për Qendrën Shtetërore të Provimeve;
- Ligjin për inspektimin arsimor;
- Ligjin për Akademinë Sportive;
- Ligjin për nëpunësit administrativë;
- Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave;
- Strategjinë për arsimin 2018–2025;
- Strategjinë për arsimin e të rriturve;
- Strategjinë për reformën e administratës publike 2023–2030;
- Strategjinë për barazi gjinore 2022–2027;
- Konceptin për arsimin fillor 2021;
- Konceptin për arsim inkluziv;
- Konceptin për hartimin e teksteve shkollore;
- Konceptin për modernizimin e arsimit teknik;
- OECD (2019), OECD Reviews of Evaluation and Assessment in Education: North Macedonia;
- dhe dokumente të tjera strategjike relevante kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Rregulloren për organizimin e brendshëm në Byronë e Zhvillimit të Arsimit;
- Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Byronë për Zhvillimin e Arsimit.

Sa i përket përmbajtjes, shtrirjes kohore dhe elementeve të tjera, plani është realist.

Gjithashtu, gjatë përgatitjes së Planit Strategjik të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit janë marrë parasysh edhe rezultatet e arritura në vitin 2024 të paraqitura në Raportin për zbatimin e Planit Vjetor të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit për vitin 2024, si dhe analiza dhe vlerësimi i rezultateve të arritura në kuadër të programeve dhe projekteve që u zbatuan gjatë vitit 2025.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

1.2.2.3. PËRCAKTIMI I PALËVE TË INTERESUARA

Është me rëndësi të madhe përcaktimi i të gjithë subjekteve ose grupeve që kanë përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, apo ndikim përkatës nga realizimi i masave dhe aktiviteteve të planifikuara me Planin Strategjik të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit.

Gjithashtu, duke pasur parasysh rëndësinë e konsultimeve me palët e interesuara, si një mekanizëm i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së punës, Byroja planifikon të bëjë vlerësimin e nivelit të interesit të palëve të interesuara (drejtorë të institucioneve arsimore, edukatorë, mësimdhënës, bashkëpunëtorë profesionalë, prindër, nxënës), me qëllim që të parashikohen aspekte të ndryshme në fushën e reagimeve, interesimit, pjesëmarrjes dhe sjelljeve të ngjashme të lidhura me implementimin dhe pasimplementimin e planit strategjik si dokument strategjik zhvillimor.

1.2.2.4. INFRASTRUKTURA NË DISPOZICION

Byroja e Zhvillimit e Arsimit nuk disponon hapësira të veta për punë (selia e Byrosë në Shkup është në pronësi të Qeverisë, ndërsa njësitë rajonale përdorin hapësira me qira). Është e nevojshme zgjidhja urgjente e marrëdhënieve pronësore-juridike të Byrosë.

Burimet materiale që Byroja e Zhvillimit të Arsimit ka në dispozicion në kuadër të njësive të saj të brendshme organizative: zyra të pajisura, linja telefonike, pajisje TIK me internet, sisteme softuerike, sistem informativ TIK të Byrosë, automjete motorike, janë në nivel të pakënaqshëm.

1.2.2.5. BURIMET FINANCIARE

Mjetet për financimin e punës së Byrosë për Zhvillimin e Arsimit sigurohen nga:

- buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ardhurat vetanake;
- donacionet.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

1.2.2.6. BURIMET NJERËZORE

Aktualisht Byroja e Zhvillimit të Arsimit numëron gjithsej 148 të punësuar.

Selia e Byrosë është në Shkup. Për kryerjen e punëve nga kompetencat e Byrosë jashtë selisë, veçanërisht për kryerjen e punës këshillimore profesionale dhe punës instruktive-mentoruese me kuadrin edukativo-arsimor dhe drejtues, janë formuar njësi rajonale në Shtip, Strumicë, Veles, Kavadar, Kumanovë, Ohër, Prilep, Tetovë dhe Gostivar.

Menaxhimi i të punësuarve në Byronë është i organizuar në mënyrë strategjike me qëllim që çdo i punësuar individualisht, si dhe të gjithë së bashku, të synojnë arritjen e objektivave të përcaktuara, duke rritur efikasitetin e punës dhe realizimin e detyrave të punës në nivelin më të lartë profesional.

Ekziston një largim shumë më i madh i kuadrin profesional përmes pensionimit, kalimit në vende të tjera pune dhe emigrimit jashtë vendit. Planet vjetore të punësimit, në të cilat parashihet numër më i madh punësimesh sesa pensionimesh, në përputhje me vendet e lira të punës në sistematizim dhe me rritjen e vëllimit të punës së Byrosë për zbatimin e reformave në arsim, nuk marrin miratim në përputhje me Ministrinë e Financave. Kjo paraqet një problem serioz në kryerjen e detyrave dhe kompetencave të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

1.2.2.7. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA

- Byroja e Zhvillimit të Arsimit bashkëpunon me institucione dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Sekretariati i Përgjithshëm i QRMV;
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë;
- Ministria e Administratës Publike;
- Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive;
- Ministria e Punëve të Jashtme;



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

- Sekretariati për Legjislacion;
- Sekretariati për Çështje Evropiane;
- Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional;
- Qendra Shtetërore e Provimeve;
- Inspektorati Shtetëror i Arsimit;
- Shërbimi Pedagogjik;
- Qendra për Arsimin e të Rriturve;
- Agjencia Kombëtare për Programet Arsimore Evropiane dhe Mobilitet;
- Kopshtet publike të fëmijëve në RMV;
- Shkollat fillore në RMV;
- Shkollat e mesme në RMV;
- Konviktet e nxënësve në RMV;
- Qendrat rajonale;
- Njësitë e vetëqeverisjes lokale në RMV;
- Zyra e Bashkimit Evropian në RMV;
- Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF);
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE);
- Zyra Programore e Këshillit të Evropës në Shkup;
- Banka Popullore e RMV;
- Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik;
- Banka Botërore në RMV;
- Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit;
- Agjencia për Rini dhe Sport;
- Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” (UKIM) – Shkup;
- Universiteti “Goce Dellçev” (UGD) – Shtip;
- Universiteti Shtetëror i Tetovës (USHT);
- Fakulteti Pedagogjik “Shën Klimenti i Ohrit” – Shkup;
- Fakulteti Pedagogjik “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir;
- Biblioteka Kombëtare dhe Universitare “Shën Klimenti i Ohrit”;
- Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ);
- Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjen e Konfliktëve;
- Fondacioni Shoqëri e Hapur në RMV;
- Fondacioni për iniciativa kulturore dhe arsimore “Hap pas Hapi” – Shkup;
- Fondacioni i Fëmijëve Pestalozzi;
- Ambasada e Parë e Fëmijëve Megjashi;
- JA Achievement – Macedonia;



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

- Zyra e UNICEF-it;
- UNFPA;
- Asociacioni për Edukim dhe Hulumtim Shëndetësor HERA;
- Korpusi i Paqes në RMV;
- Organizata ndërkombëtare IREX;
- Instituti Maqedonas për Media (MIM);
- Instituti për Studime të Komunikimit (ISK);
- Forumi Rinor Arsimor (FRA).

1.3. MISIONI

Avancimi dhe zhvillimi i veprimtarisë edukativo-arsimore në fushën e arsimit parashkollor, fillor, gjimnaz, artistik, lëndëve të përgjithshme arsimore në arsimin e mesëm profesional, arsimin specialistik, arsimin të rriturve, arsimin të fëmijëve me nevojë të veçanta arsimore, veprimtarisë edukativo-arsimore në konviktet e nxënësve, si dhe arsimin të fëmijëve të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në diasporë për mësimin e gjuhës amtare dhe kulturës.

Misionin e saj Byroja e Zhvillimit të Arsimit e realizon përmes zhvillimit të planeve dhe programeve të reja mësimore, hulumtimeve zhvillimore, këshillimeve dhe trajnimeve të kuadrit edukativo-arsimor, monitorimit të arritjeve të nxënësve, publikimit të udhëzuesve, revistave dhe materialeve të tjera didaktike për mbështetjen e procesit mësimor.

1.4. VIZIONI

Sigurimi i një arsimit dhe edukimit cilësor për gjeneratat e reja, për fitimin e kompetencave të nevojshme për përfshirje të suksesshme dhe aktive në jetën e përgjithshme dhe në tregun e punës.



1.5. DETYRAT DHE OBLIGIMET E BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Byroja e Zhvillimit të Arsimit, në përputhje me obligimet e përcaktuara me ligj, kryen detyrat e mëposhtme:

- harton koncepte për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor, standarde arsimore, plane dhe programe mësimore për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe specialistik, arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimin e të rriturve;
- kryen dhe organizon hulumtime në fushën e arsimit si bazë për zhvillimin e politikave arsimore në shtet;
- organizon dhe realizon aktivitete për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor;
- monitoron dhe vlerëson realizimin e veprimtarisë edukativo-arsimore dhe jep mbështetje profesionale-këshillimore për kuadrin edukativo-arsimor;
- harton koncept për tekstet shkollore, program për botimin e teksteve shkollore dhe metodologji për vlerësimin profesional të dorëshkrimeve të teksteve dhe për vlerësimin e cilësisë së teksteve shkollore;
- lëshon dokumentacion dhe evidencë pedagogjike për arsimin fillor dhe të mesëm;
- krijon dhe zhvillon sistem informativ-dokumentues në kuadër të kompetencave të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

1.6. SPECIFIKA E BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Byroja e Zhvillimit të Arsimit është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me status të personit juridik.



1.7. STRUKTURA E BYROSE SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Në kuadër të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit janë institucionalizuar shtatë sektorë dhe tre njësi të pavarura.

- **Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore**, me kompetencë kryesore për të hartuar koncepte për zhvillimin e sistemit arsimor, plane dhe programe mësimore për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe specialistik, si dhe për arsimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimin e të rriturve. Për realizimin e kësaj veprimtarie, sektori përgatit analiza dhe organizon diskutime, mbi bazën e të cilave përcakton nevojat për zhvillimin e planeve dhe programeve mësimore dhe dokumenteve të tjera konceptuale.

Në kuadër të këtij sektori janë institucionalizuar tre njësi:

- Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe në mësimin klasor;
 - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor në arsimin fillor;
 - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin gjimnazial, arsimin artistik dhe për lëndët e përgjithshme arsimore.
- **Sektori për hulumtime në arsim**, me kompetencë kryesore për të studiuar, realizuar hulumtime zhvillimore dhe vepruese që lidhen me zhvillimin dhe përmirësimin e punës edukativo-arsimore, për të hartuar plane vjetore për zhvillimin e hulumtimeve, për të organizuar dhe koordinuar punën e ekipeve profesionale që punojnë në hulumtime zhvillimore, për të ndjekur realizimin e hulumtimeve dhe për të informuar shkollat dhe institucionet e tjera, si dhe për të organizuar diskutime profesionale dhe shkencore mbi tema dhe probleme aktuale në vend dhe në shtete të tjera, duke nxitur zbatimin e rezultateve të hulumtimeve në fushën e arsimit.

Në kuadër të këtij sektori janë institucionalizuar dy departamente:

- Njësoia për hulumtim, zhvillim dhe çështje sistemore;



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

- Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar.

- **Spektori për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor dhe punë këshillimore profesionale**, me kompetencë kryesore për të përgatitur analiza dhe, në bazë të tyre, për të përcaktuar nevojat për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor (mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë), për të organizuar diskutime tematike lidhur me zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor dhe drejtues, për të hartuar plan afatgjatë për nevojat e trajnimit të kuadrit edukativo-arsimor, si dhe për të hartuar plan afatgjatë dhe vjetor të aktiviteteve për trajnim të kuadrit edukativo-arsimor, të zbatojë procedurat për akreditim për ofrimin e shërbimeve lidhur me realizimin e programeve të trajnimit të kuadrit edukativo-arsimor, si dhe të hartojë metodologji dhe mjete për realizimin e vizitave këshillimore dhe vëzhgimeve profesionale, të përgatisë plan vjetor për realizimin dhe përditësimin e tyre.
Në kuadër të këtij sektori janë institucionalizuar dy departamente:
 - Njësia për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor;
 - Njësia për punë këshillimore-profesionale.

- **Spektori për veprimtari botuese** ka kompetencë të: propozojë formularë për evidencë dhe dokumentacion pedagogjik; të mbledhë të dhëna për numrin e nxënësve dhe numrin e klasave sipas gjuhës së mësimin nga të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut; të përgatisë përmbledhje për numrin e nxënësve dhe numrin e klasave sipas gjuhës së mësimin për shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut; të hartojë Planin Botues të Byrosë dhe plane për shpërndarjen e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike për shkollat fillore dhe të mesme; të lëshojë dokumentacion dhe evidencë pedagogjike për arsimin fillor dhe të mesëm; të realizojë procedura të prokurimit publik për shtypjen e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike dhe t'i dërgojë ato falas në shkolla; të ndjekë realizimin e shërbimeve të ofruesve të përzgjedhur në lidhje me cilësinë dhe afatet e përcaktuara; të ndjekë shpërndarjen e dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike të shtypur dhe dorëzimin e tyre në shkolla; të botojë plane dhe programe mësimore për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe specialistik, për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe për arsimin fillor të të rriturve; të botojë udhëzues dhe literaturë tjetër ndihmëse për edukatorët, mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë; të zhvillojë



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

përmbajtje digjitale për realizimin cilësor të mësimin, të krijojë kurse online dhe të organizojë mbështetje profesionale për këshilltarët për realizimin e kurseve online.

Në kuadër të këtij sektori janë institucionalizuar dy njësi:

- Njësia për veprimtari botuese dhe dokumentacion pedagogjik;
- Njësia për zhvillimin e përmbajtjeve digjitale dhe kurseve online.

- **Sektori për monitorimin dhe evaluimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve** kryen hulumtime për monitorimin dhe evaluimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve, zhvillon metoda dhe procedura didaktike bashkëkohore për monitorimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve, realizon verifikime të jashtëzakonshme ekstreme të arritjeve të nxënësve, përgatit dhe siguron mbështetje për procesin e vetëvlerësimit të shkollave, si dhe mbështetje gjatë realizimit të maturës shtetërore. Në bashkëpunim me Qendrën Shtetërore të Provimeve (QSHP) siguron mbështetje dhe trajnime për mësimdhënësit në arsimin fillor dhe të mesëm për testimet ndërkombëtare PISA, TIMSS dhe PIRLS.

Në përbërje të Sektorit për monitorimin dhe evaluimin e arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve, përveç departamentit me të njëjtin emër, janë edhe njësitë rajonale të Byrosë në Shtip, Strumicë, Veles, Kavadar, Kumanovë, Ohër, Prilep, Tetovë dhe Gostivar.

- **Sektori për logjistikë** ka kompetencë kryesore për punë studimore-analitike dhe administrative-teknike, përkatësisht veprimtari normative-juridike të lidhura me veprimtarinë e Byrosë (rregullore, udhëzime, procedura dhe akte të ngjashme), përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore dhe rregulloreve të tjera nga fusha e arsimit, realizimin e procedurave për sigurimin e shërbimeve për hartimin e programeve të reja mësimore ose modernizimin e programeve ekzistuese në përputhje me ligjin, realizimin e procedurave të akreditimit për ofrimin e shërbimeve lidhur me zbatimin e programeve të trajnimit për kuadrin edukativo-arsimor dhe drejtues, si dhe realizimin e procedurave për sigurimin e shërbimeve të lidhura me fundamentet, hulumtime në arsim të përcaktuara me programin e punës dhe me ligjet për arsimin fillor dhe të mesëm.

Në kuadër të këtij sektori janë institucionalizuar dy njësi:

- Njësia për çështje normative-juridike dhe punë zyre;



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

- Njësia për prokurime publike dhe punë të përgjithshme.
- **Spektori për çështje financiare** ka kompetencë kryesore të kryejë punë që lidhen me: përgatitjen e propozim-buxhetit për Byronë, QZAP dhe QSHP (si përdorues të linjës së dytë të buxhetit të Byrosë); përgatitjen e planeve financiare vjetore dhe tremujore; ndjekjen dhe zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve të tjera që lidhen me kontabilitetin dhe buxhetin dhe me përdorimin dhe disponimin e mjeteve të organeve shtetërore; ndjekjen e gjendjes dhe lëvizjes së mjeteve dhe burimeve të mjeteve të Byrosë; përgatitjen e planit financiar të Byrosë; ndjekjen e realizimit të të ardhurave dhe kryerjes së shpenzimeve; përpilimin, pranimin, likuidimin dhe kontrollin e dokumenteve kontabël; llogaritjen dhe pagesën e pagave; mbajtjen e evidencës së pagave të nëpunësve shtetërorë, punonjësve të tjerë dhe personave të emëruar në Byronë; veprimtarinë e arkës; hapjen e akreditivave dhe transferimin e mjeteve në departamentet e njësive rajonale dhe mbylljen e tyre; mbajtjen e librave afaristë të parashikuar me Ligjin për kontabilitet; harmonizimin e mjeteve dhe burimeve të mjeteve të gjendjes kontabël me gjendjen reale; llogaritjen e amortizimit dhe rivlerësimit; si dhe përgatitjen e llogarisë përfundimtare të Byrosë.

Në kuadër të këtij sektori janë institucionalizuar tre njësi:

- Njësia për koordinim buxhetor;
 - Njësia për kontroll buxhetor;
 - Njësia për kontabilitet dhe pagesa.
- **Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore** ka kompetencë kryesore të kryejë punë që lidhen me strukturën organizative të Byrosë; të përgatisë program vjetor për aftësim dhe avancim profesional të nëpunësve shtetërorë dhe të ndjekë përparimin e tyre; të mbajë evidencë personale/dosje, pushime vjetore, pushime të paguara dhe mungesa për shkak sëmundjeje për të punësuarit e Byrosë; të realizojë anketa dhe analiza për funksionim efikas dhe për problemet në praktikën e departamenteve, si dhe për identifikimin e dobësive në sistem; të realizojë procedura për punësim dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës; të japë udhëzime lidhur me vlerësimin e nëpunësve shtetërorë dhe të shpërndajë formularët për vlerësimin e tyre; si dhe të dorëzojë raport vjetor për vlerësimin e nëpunësve shtetërorë në Agjencinë për Administratë (AA).
 - **Njësia për auditim të brendshëm** ka kompetencë kryesore të rrisë efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe të japë rekomandime për eliminimin e



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

parregullsive dhe dobësive të konstatuara, të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të dhëna, të përgatisë strategji, plane dhe informacione lidhur me auditimin e brendshëm, si dhe të ruajë dokumentacionin për auditimet e realizuara dhe të bashkëpunojë me auditorët e Entit Shtetëror të Revizionit.

- **Njësia për planifikim strategjik, krijim politikash dhe monitorim, analizë kryen** koordinimin e përgatitjes së Planit Strategjik dhe ndjek zbatimin e tij të rregullt, vlerësimin e rezultateve të arritura dhe raportimin; kryen punë studimore-analitike në lidhje me përcaktimin e prioriteteve strategjike të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit; ndjek zbatimin e prioriteteve strategjike të Byrosë dhe të Qeverisë; organizon dhe nxit bashkëpunimin në procesin e përgatitjes së vendimit për përcaktimin e prioriteteve strategjike dhe jep propozime me masa; ndjek problemet sistemore dhe aktuale që paraqiten gjatë zbatimit të prioriteteve strategjike; bën përpunimin profesional të çështjeve që kanë rëndësi për zbatimin e dispozitave ligjore; përgatit teza për hartimin e ligjeve dhe rregulloreve të tjera, akteve të përgjithshme dhe punëve informative-analitike; si dhe përgatit analiza, raporte dhe informacione në lidhje me planifikimin strategjik.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Byroja e Zhvillimit të Arsimit

Drejtor

Zëvendësdr
tor

Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore

Sektori për hulumtime në arsim

Sektori për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor dhe punë këshillimore

Sektori për veprimtari botuese

Sektori për monitorimin dhe vlerësimin e nxënësve dhe mësimdhënësve

Sektori për logjistikë

Sektori për çështje financiare

Departamenti për menaxhimin e burimeve njerëzore

Departamenti për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe në mësimin klasor

Departamenti për hulumtim, zhvillim dhe çështje sistemore

Departamenti për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor

Departamenti për veprimtari botuese dhe dokumentacion pedagogjik

Departamenti për monitorimin dhe vlerësimin e nxënësve dhe mësimdhënësve

Departamenti për çështje normative-juridike dhe punë zyre

Departamenti për koordinim buxhetor

Departamenti për auditim të brendshëm

Departamenti për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor në arsimin fillor

Departamenti për projekte kërkimore dhe bashkëpunim ndërkombëtar

Departamenti për punë këshillimore profesionale

Departamenti për zhvillimin e përmbajtjeve digjitale dhe kurseve online

Departamente rajonale me seli në Shtip, Strumicë, Veles, Kavadar, Kumanovë, Ohër, Prilep, Tetovë dhe Gostivar.

Departamenti për prokurime publike dhe punë të përgjithshme

Departamenti për kontroll buxhetor

Departamenti për kontabilitet dhe pagesa

Departamenti për planifikim strategjik, krijim politikash dhe monitorim, analizë



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

1.8. MARRËDHËNIET ME ORGANET NË PËRBËRJE

Përdorues të linjës së dytë të buxhetit të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit janë: Qendra Shtetërore e Provimeve dhe Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional.

1.9. PRIORITETET DHE QËLLIMET E BYROSË SË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Prioritet: Përmirësimi dhe zhvillimi i procesit edukativo-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm

Qëllime:

- hartimi/rishikimi i standardeve kombëtare arsimore për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- hartimi i programeve të reja mësimore për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm (gjimnaz, artistik dhe lëndë të përgjithshme në arsimin profesional) në përputhje me dinamikën e zbatimit të Konceptit për arsimin fillor dhe reformat e ardhshme në arsimin e mesëm;
- hulumtime dhe analiza për përmirësimin e aspekteve kryesore të procesit edukativo-arsimor;
- zhvillimi i koncepteve dhe akteve nënligjore në përputhje me Ligjin për Arsimin fillor, Ligjin për Arsimin e mesëm dhe Ligjin për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme;
- hartimi i një Ligji të ri për Byronë e Zhvillimit të Arsimit;
- modernizimi i programeve mësimore për lëndët e përgjithshme në arsimin e mesëm profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe ekonomisë;



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Prioritet: Forcimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe të karrierës së kuadrit edukativo-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm

Qëllime:

- forcimi i kompetencave të nevojshme të kuadrit edukativo-arsimor për realizim cilësor të procesit edukativo-arsimor përmes ndjekjes së trajnimeve të akredituara dhe sigurimit të zhvillimit në karrierë;
- zhvillimi i procedurave dhe instrumenteve për ndjekjen dhe përmirësimin e punës së kuadrit edukativo-arsimor, si dhe për ndjekjen e procesit edukativo-arsimor;
- sigurimi i ndihmës së vazhdueshme këshillimore-profesionale për shkollat për ndryshimet konceptuale dhe sistemore në procesin edukativo-arsimor.

Prioritet: Përmirësimi i procesit të ndjekjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve

Qëllime:

- reformimi i procesit të ndjekjes dhe vlerësimit;
- forcimi i aftësive të mësimdhënësve për vlerësim objektiv;
- harmonizimi i dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike në përputhje me kërkesat dhe nevojat në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Përparësi: Zgjidhja e marrëdhënieve pronëso-ro-juridike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit

Qëllimi:

- disponimi me hapësira të veta për punë në Shkup dhe në njësitë rajonale.



1.10. PASQYRË E REZULTATEVE TË ARRITURA NGA VITI 2024

Byroja e Zhvillimit të Arsimit, në përputhje me kompetencat dhe në drejtim të përmbushjes së prioriteteve dhe qëllimeve, planifikon aktivitete që zbatohen rregullisht duke siguruar vazhdimësi dhe ndërlidhje të ndërsjellë.

Pasqyra e rezultateve të arritura nga viti 2024 përfshin edhe komponentët kryesorë të funksioneve, përshkrimin e tyre, si dhe informacione që tregojnë rezultatet e arritura.

Qëllimet/rezultatet e projektuara dhe aktivitetet janë të grupuara nën çdo prioritet strategjik, por janë të lidhura ndërmjet tyre horizontalisht/vertikalisht nëpër të gjitha qëllimet strategjike me ndikime të forcuara në drejtim të prioriteteve.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit në vitin 2024 ka punuar intensivisht në të gjitha segmentet e kompetencës së saj.

Në vijim janë paraqitur disa nga rezultatet dhe aktivitetet kryesore të projektuara:

- **Arsimi parashkollor:** Me përdorimin e instrumentit Melqo (MELQO), për herë të parë në vendin tonë është realizuar një hulumtim për matjen e cilësisë në edukimin dhe arsimin parashkollor. Të dhënat e marra do të përdoren për rishikimin e standardeve për të nxëniet dhe zhvillimin e hershëm dhe për rishikimin e programit për të nxëniet dhe zhvillimin e hershëm të fëmijëve nga 0 deri në 6 vjeç.

- **Arsimi fillor:** Janë përgatitur 20 programe mësimore për klasën e tetë për të gjitha lëndët, duke përfshirë gjuhët, shkencat natyrore, shkencat shoqërore, artet, arsimin teknik dhe sportin. Për lëndët zgjedhore të lira për periudhën e dytë dhe të tretë të arsimit fillor janë përgatitur 9 programe, si dhe programe shtesë për klasën e nëntë. Janë përgatitur disa programe mësimore për lëndët Gjuha dhe kultura e serbëve dhe Gjuha dhe kultura e turqve për disa klasa, si dhe për lëndët Biologji, Kimi, Fizikë, Histori, Gjeografi dhe Edukim qytetar për klasën e shtatë. Janë bërë plotësime të programeve ekzistuese për klasën e shtatë dhe janë miratuar plane të reja për vitin shkollor 2024/25, duke përfshirë plane mësimore për nxënës me dëmtime në shikim, dëgjim, vështirësi mendore, multihandikap dhe autizëm. Janë trajnuar 1877 mësime për planifikimin dhe realizimin e mësimit në klasën e gjashtë për vitin shkollor 2024/25. Në kuadër të projektit Përmirësimi i arsimit fillor janë trajnuar gjithsej 15.985 mësime dhe 874 bashkëpunëtorë profesionalë. Janë përgatitur udhëzime për organizimin dhe realizimin e mësimit, ndryshime dhe plotësime të konceptit për arsimin fillor, si dhe një instrument për ndjekjen dhe vlerësimin e punës së mësimeve. Janë analizuar 5 tekste shkollorë për klasën e gjashtë dhe 9 tekste për klasën e shtatë për lëndë të ndryshme, si dhe analiza e literaturës profesionale dhe e



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

revistave për fëmijë. Janë realizuar vëzhgime profesionale në mbi 1024 orë mësimore në 323 shkolla, me raporte të përgatitura për vëzhgimin profesional. Është siguruar mbështetje gjatë zbatimit të testimit TIMSS.

- Arsimi i mesëm: Është përgatitur një program mësimor për gjuhën gjermane për vitin e parë të arsimit gjimnazial, me mësim eksperimental me fond prej 6 orësh në javë. Për dhënien e maturës shtetërore janë përgatitur dy programe të reja provimi për lëndët gjuha dhe letërsia serbe, si dhe gjuha italiane, të cilat vlejné për arsimin gjimnazial, artistik dhe arsimin e mesëm profesional. Për vitin shkollor 2024/2025 janë përgatitur teste nga matematika dhe fizika për provimin pranues në Gjimnazin Matematiko-Informatik, si dhe teste për testim kualifikues nga gjuha amtare, matematika, biologjia dhe kimia për regjistrim në arsimin gjimnazial dhe në arsimin e mesëm profesional shëndetësor. Janë përgatitur propozime për Ligj të ri për arsimin e mesëm, Ligj për arsimin e mesëm profesional dhe dokumenti me titull “Korniza kombëtare e kompetencave kyçe për nxënësit në arsimin e mesëm”. Janë realizuar aktivitete nga Programi për mbrojtjen e konsumatorëve për vitin 2024, duke përfshirë konkursin artistik “Ballafaqimi me ndotjen nga plastika”, punëtori për edukatorët e kopshteve për shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve, si dhe punëtori për mësimdhënës dhe nxënës nga shkollat e mesme në Manastir, Resnjë dhe Demir Hisar për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. Janë analizuar nevojat për trajnim të mësimdhënësve në shkollat e mesme, gjë që mundësoi përzgjedhjen e temave për trajnim përmes projektit të IPA-s. Është akredituar një program trajnimi dhe ofruar për aftësitë digjitale të mësimdhënësit, me gjithsej 2.001 mësimdhënës të trajnuar. Është ndjekur realizimi dhe cilësia e trajnimeve përmes 10 grupeve, me vizita dhe vëzhgime profesionale në shkollat e mesme me paralele dygjuhëshe frankofone. Është përgatitur një raport me masa konkrete për përmirësimin e rezultateve nga PISA 2022, duke u fokusuar në nxitjen e të menduarit kritik dhe kreativ të nxënësit për realizim më efektiv të mësimin dhe zbatimin e njohurive në jetën praktike. Janë realizuar trajnime për mësimdhënës që japin mësim në vitin e parë në gjuhë amtare, shkenca natyrore, matematikë dhe informatikë, me gjithsej 840 mësimdhënës pjesëmarrës në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Është siguruar mbështetje gjatë zbatimit të maturës shtetërore dhe testimit shtetëror. Është realizuar një hulumtim me temë “Reforma në arsimin gjimnazial”, me qëllim zhvillimin e politikave të mëtejshme për përmirësimin e arsimit gjimnazial. Është përgatitur një raport që paraqet në mënyrë të detajuar reformat dhe rekomandimet për hapat e ardhshëm.

- janë shtypur dhe janë lëshuar formularë të dokumentacionit pedagogjik për arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhën maqedonase, shqipe, turke, serbe dhe boshnjake.



Një pjesë e aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2024 Byroja e Zhvillimit të Arsimit i realizoi me ndihmë profesionale dhe mbështetje nga organizata joqeveritare, ndërsa një pjesë edhe me angazhimin e ekspertëve të jashtëm, organizimin e trajnimeve për mësimdhënës dhe përgatitjen e dokumenteve dhe materialeve për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe për mbështetjen e mësimdhënësve.

- Bashkëpunim me UNICEF
- Bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Shkup
- Zyra e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër krimit dhe drogës (UNODC)
- Bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare IREX
- Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim HERA.

1.11. PASQYRË E REZULTATEVE TË ARRITURA NGA VITI 2025

Përmes aktiviteteve të paraqitura në raportin gjysmëvjetor të statusit të programit/nënprogrameve nga Plani vjetor i punës së Byrosë për vitin 2025 mund të shihet se Plani vjetor në pjesën më të madhe është realizuar. Aktivitetet dhe detyrat e punës së të punësuarve, në masën më të madhe, janë kryer me cilësinë e nevojshme dhe janë arritur qëllimet e vendosura dhe të pritshme, gjithashtu janë realizuar aktivitete dhe detyra që nuk ishin parashikuar me planin e punës për vitin aktual.

Në përputhje me kompetencat e saj dhe në drejtim të përmbushjes së prioriteteve dhe qëllimeve të saj, Byroja e Zhvillimit të Arsimit në vitin 2025 arriti rezultatet e mëposhtme të dëshiruara dhe të planifikuara:

- **Arsimi parashkollor:** Përmes projektit për përmirësimin e shërbimeve sociale, me mbështetjen e Bankës Botërore, përfundoi zbatimin e modulit të tretë të trajnimeve me temë “Inkluzioni dhe mjedisi i të nxënimit” për zhvillimin profesional të kuadrit profesional të institucioneve për kujdes, edukim dhe arsimim të fëmijëve në kopshtet e fëmijëve në R. e Maqedonisë së Veriut. Janë trajnuar gjithsej 1567 pjesëmarrës, prej të cilëve 1384 edukatorë dhe 183 drejtorë dhe punonjës/bashkëpunëtorë profesionalë. Është përgatitur raport për trajnimin e realizuar “Inkluzioni dhe mjedisi i të nxënimit” në kuadër të projektit.
- **Arsimi fillor:** Janë përgatitur dhe miratuar 3 programe të reja mësimore për klasat V–VII, 24 për klasën VIII për të gjitha lëndët, si dhe tre për lëndët zgjedhore të lira. Është planifikuar zbatimin e tyre nga viti shkollor 2025/26, 9 për arsimin fillor në institucionet edukativo-korrektuese; 9 për arsimin fillor të të rriturve; plane mësimore për arsimin fillor



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

në institucionet edukativo-korrektuese dhe për nxënës me nevoja të veçanta (autizëm, multihandikap, pengesa në zhvillimin psikik, dëmtime në shikim dhe dëgjim), si dhe për të rriturit. Trajnimet e mësimdhënësve të arsimit fillor për planifikimin dhe realizimin e mësimin sipas programeve të reja janë realizuar për 5230 mësimdhënës. Trajtime të veçanta për mësimin e lëndës Inovacione në klasën IX përfshinë 12 mësimdhënës. Në të njëjtën kohë, të gjithë mësimdhënësit e lëndëve u trajnuan për realizimin e punës shoqërore-humanitare nga klasa VII. Janë analizuar 55 tekste shkollorë/dorëshkrime për tekste për klasën e shtatë, 94 tekste për klasa të tjera, 4 tekste për lëndë zgjedhore dhe 82 fletore pune të dorëzuara dhe për të gjitha janë përgatitur mendime profesionale. Janë realizuar vëzhgime të përgjithshme në 334 shkolla (që është rreth 99% e numrit të përgjithshëm). Janë vizituar 1087 orë mësimore në të gjitha lëndët, me raporte të përgatitura për vëzhgimin profesional. Janë shtypur materiale didaktike për klasën e parë, të dytë dhe të tretë, si dhe janë përkthyer dhe redaktuar në pesë gjuhë (maqedonisht, shqip, turqisht, serbisht, boshnjakisht); janë përgatitur dhe miratuar 11 rregullore për arsimin fillor. Është realizuar hulumtimi: “Shkrim-leximi financiar në arsimin fillor”.

- **Arsimi i mesëm:** Janë përgatitur 20 programe mësimore për vitin e parë të arsimit gjimnazial për të gjitha lëndët, si dhe programe mësimore për vitin e tretë dhe të katërt (duke përfshirë paralele të specializuara për gjuhën italiane dhe franceze). Për vitin e dytë janë përgatitur 19 programe për lëndë të ndryshme, me përfshirjen e programeve eksperimentale për gjuhën gjermane. Janë përgatitur 2 programe për maturë shkollorë, 15 për maturë shtetërore profesionale, 10 për maturë shtetërore artistike, 3 për maturë shkollorë profesionale, 2 për maturë shkollorë artistike dhe 2 për provim përfundimtar. Plane mësimore për paralele dygjuhëshe (gjuhë amtare – anglisht) dhe për mësim eksperimental me gjuhën gjermane me fond të ndryshëm javor orësh. Janë realizuar trajnime për mësimdhënës të arsimit gjimnazial për planifikimin dhe realizimin e mësimin sipas programeve të reja, me gjithsej 806 mësimdhënës të trajnuar për vitin e parë. Janë përgatitur 8 rregullore për arsimin e mesëm, teste për provimin pranues në Gjimnazin Matematiko-Informatik, teste për testim kualifikues për regjistrim në shkollat e mesme për vitin shkollor 2025/26, si dhe një instrument për vëzhgim profesional në shkollat e mesme për vitin e ardhshëm shkollor. Janë analizuar 53 tekste për vitin e parë të arsimit gjimnazial dhe janë përgatitur mendime profesionale.

Janë akredituar dy (2) programe me përparësi për trajnim të mësimdhënësve: “Zbatimi i mjeteve digjitale për mësim interaktiv dhe të personalizuar” (janë realizuar gjithsej 262 trajnime, përkatësisht janë trajnuar 5.771 mësimdhënës; nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të trajnuar, 3.924 janë gra dhe 1.847 janë burra), dhe “Nxitja e një mënyre të qëndrueshme të të menduarit të nxënësit për zgjidhjen e sfidave globale ekologjike” (janë



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

realizuar gjithsej 240 trajnime, përkatësisht janë trajnuar 5.732 mësimdhënës; nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të trajnuar, 3.729 janë gra dhe 2.003 janë burra). Është akredituar/realizuar një (1) program prioritar për trajnim të bashkëpunëtorëve profesionalë dhe këshilltarëve të karrierës në shkollat e mesme me temë: “Forcimi i aftësive të bashkëpunëtorëve profesionalë për këshillim në orientimin profesional dhe të karrierës të nxënësit” (janë realizuar gjithsej 20 trajnime, përkatësisht janë trajnuar 486; nga numri i përgjithshëm i bashkëpunëtorëve profesionalë dhe këshilltarëve të karrierës të trajnuar, 409 janë gra dhe 77 janë burra).

Është përgatitur Propozim-Koncept për përgatitjen e teksteve shkollore dhe është përgatitur Propozim-Metodologji për vlerësimin e tekstit shkollor dhe janë dërguar te ministri i Arsimit dhe Shkencës për miratim. Janë përgatitur kritere për vlerësimin e fletoreve të punës për gjuhë të huaj nga grupi i punës i formuar për këtë qëllim dhe të njëjtat janë miratuar nga drejtori i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit. Është përgatitur program për realizimin e aktiviteteve për mbrojtjen e konsumatorëve. Është realizuar aktiviteti i parë sipas programit: konkurs artistik për fëmijët e kopshteve dhe për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme me rastin e 15 marsit – Ditës Botërore të të Drejtave të Konsumatorëve, i organizuar në 4 kategori. Janë ndarë çmime për nxënësit në një ngjarje të organizuar nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit në bashkëpunim me Fakultetin Pedagogjik “Shën Klimenti i Ohrit” me rastin e Ditës së të Drejtave të Konsumatorëve.

Është përgatitur propozim-program për përsosjen profesionale të mësimdhënësve të shkollave fillore dhe të mesme për vitin 2025 dhe propozim-program për përsosjen profesionale të bashkëpunëtorëve profesionalë të shkollave fillore dhe të mesme për vitin 2025 (të njëjtat janë miratuar nga ministrja e arsimit dhe shkencës). Është përgatitur dhe miratuar një rregullore e re për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor (mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë) në shkollat fillore dhe të mesme.

Është përgatitur propozim-koncept për përgatitjen e teksteve shkollore dhe është përgatitur propozim-metodologji për vlerësimin e tekstit shkollor; janë përgatitur kritere për vlerësimin e fletoreve të punës për gjuhë të huaja; janë përgatitur kritere për vlerësimin e fletoreve të punës për të gjitha lëndët mësimore.

Janë shtypur dhe janë lëshuar formularë të dokumentacionit pedagogjik për arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhën maqedonase, shqipe, turke, serbe dhe boshnjake; është kryer redaktim gjuhësor, përkthim, redaktim letrar dhe rregullim teknik (korrigjim). Është



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

botuar edhe monografia “BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT/70 VJET DIJE, VIZION,
PËRKUSHTIM DHE ZHVILLIM / MONOGRAFI 1955–2025”.

Një pjesë e aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2025 Byroja e Zhvillimit të Arsimit i realizoi me ndihmë profesionale dhe mbështetje nga organizata joqeveritare, ndërsa një pjesë edhe me angazhimin e ekspertëve të jashtëm, organizimin e trajnimeve për mësimdhënës dhe përgatitjen e dokumenteve dhe materialeve për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe për mbështetjen e mësimdhënësve.

- Bashkëpunim me UNICEF
- Bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Shkup
- Zyra e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër krimit dhe drogës (UNODC)
- Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim HERA.



2. PROGRAMET

Programi 1: Arsim cilësor parashkollor, fillor dhe i mesëm

2.1. Plani për zbatimin e Programit: Arsim cilësor parashkollor, fillor dhe i mesëm

A: Arsyetimi dhe dizajni i Programit 1

Arsyetim: Programi Arsim cilësor parashkollor, fillor dhe i mesëm rrjedh nga:

1. Përparësia strategjike e Qeverisë së RMV-së, e përfshirë në Vendimin për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e përparësive strategjike për periudhën 2024–2028, është “përmirësimi gjithëpërfshirës i cilësisë, infrastrukturës dhe aksesueshmërisë në arsim, krijimi i një shoqërie të bazuar në dije dhe përballimi i suksesshëm i sfidave bashkëkohore”.

Njëkohësisht, Programi buron nga objektivat parësore të përfshira në Vendimin për përparësi strategjike për periudhën 2024–2028, përkatësisht: “përmirësimi i cilësisë së arsimit, zhvillimi i planeve dhe programeve mësimore, metodave të mësimdhënies, teksteve shkollore, përmbajtjeve dhe burimeve digjitale në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënit”, si dhe “zhvillimi i pajisjeve kombëtare të TIK - arsimore dhe kërkimore”.

2. Klasteri i NPAA-së 3. Konkureshmëri dhe rritje gjithëpërfshirëse

3.26. Arsimi, kultura dhe rinia

3.26.1 Arsimi

Prioritetet strategjike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:

- përmirësimi dhe zhvillimi i procesit edukativo-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- forcimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe të karrierës së kuadrit edukativo-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- përmirësimi i procesit të ndjekjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve.

Qëllimet parësore të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:

- të implementohen reformat në arsimin fillor në përputhje me Konceptin e arsimit fillor, duke përfshirë edhe Konceptin e arsimit gjithëpërfshirës;
- të përcaktohet Koncepti i Arsimit të mesëm gjimnazor dhe të zhvillohen plani



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

mësimor dhe programet mësimore.

- të monitorohet zbatimi i reformave në arsimin e mesëm në gimnaz;
- të zhvillohen hulumtime për avancimin e arsimit;
- të përmirësohen kompetencat e kuadrit edukativo-arsimor;
- të sigurohet ndjekja e mësimdhënësve përmes vlerësimeve profesionale dhe garantimi i zhvillimit të tyre në karrierë.

Qëllimi i Programit: Përmirësimi i cilësisë së njohurive të fëmijëve dhe nxënësve.

Treguesit e suksesit të Programit:

- standarde të hartuara/rishikuara për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- programe mësimore, koncepte dhe akte nënligjore të reja të hartuara;
- numri i hulumtimeve dhe analizave nga fusha e arsimit;
- numri i kuadrit edukativo-arsimor të trajnuar me kompetenca të forcuara;
- numri i vizitave për ndjekjen dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë;
- dokumentacion dhe evidencë pedagogjike e shtypur dhe e shpërndarë.

Programi është: (shënoni llojin e Programit)

✓ Horizontale

✓ Vertikale

Nënprogramet (komponentët) e Programit: Arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm me cilësi të përmirësuar.

Nënprogrami 1:

Standardet për arsimin parashkollor

Tregues i suksesit për vitet 2026, 2027 dhe 2028:

- Hartimi i një programi për mësimin dhe zhvillimin e hershëm të fëmijëve nga 0 deri në 6 vjeç;
- Numri i punonjësve edukativo-arsimor të trajnuar për zbatimin e programit të ri, për përdorimin e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik të rishikuar, si dhe për tema të tjera që lidhen me procesin edukativo-arsimor për vitet 2026, 2027 dhe 2028.

Nënprogrami 2:

Tregues i suksesit për vitin 2026, 2027



<p>Standardet, planet dhe programet mësimore për arsimin fillor</p>	<p>dhe 2028:</p> <ul style="list-style-type: none">- Numri i programeve mësimore të reja të hartuara bazuar në standardet kombëtare për vitet 2026, 2027 dhe 2028;- Numri i dokumenteve të hartuara që lidhen me procesin edukativo-arsimor në arsimin fillor;- Numri i kuadrit edukativo-arsimor të trajnuar për zbatimin e programeve të reja mësimore për vitet 2026, 2027 dhe 2028;- Numri i kuadrit edukativo-arsimor të trajnuar për tema të tjera që lidhen me procesin edukativo-arsimor për vitet 2026, 2027 dhe 2028.
<p>Nënprogrami 3: Standardet, planet dhe programet mësimore për arsimin e mesëm (gjimnaz, artistik, gjimnaz sportiv, akademi sportive, arsimit i mesëm profesional, arsimit për nxënës me nevoja të veçanta arsimore dhe gjimnazi matematikë-informatikë)</p>	<p>Tregues i suksesit për vitin 2026, 2027 dhe 2028:</p> <ul style="list-style-type: none">- Hartimi i Kornizës Kombëtare të Kompetencave Kryesore për nxënësit në arsimin e mesëm;- Numri i programeve të reja mësimore të hartuara për vitin 2026, 2027 dhe 2028;- Numri i kuadrit edukativo-arsimor të trajnuar për zbatimin e programeve të reja mësimore për vitin 2026, 2027 dhe 2028;- Numri i dokumenteve të hartuara që lidhen me procesin edukativ-arsimor në arsimin e mesëm;- Numri i kuadrit edukativ-arsimor të trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës dhe për tema të tjera që lidhen me procesin edukativ-arsimor për vitin 2026, 2027 dhe 2028.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Nënprogrami 4: Hulumtim/kërkim për përmirësimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm	Tregues i suksesit për vitin 2026, 2027 dhe 2028: <ul style="list-style-type: none">- numri i analizave për vitin 2026, 2027 dhe 2028;- numri i kërkimeve për vitin 2026, 2027 dhe 2028.
Nënprogrami 5. Zhvillim profesional i vazhdueshëm i kuadrit edukativo-arsimor (mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë) dhe punë këshillimore profesionale në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm	Tregues i suksesit për vitin 2026, 2027 dhe 2028: <ul style="list-style-type: none">- Numri i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të trajnuar përmes programeve të akredituara të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për vitet 2026, 2027 dhe 2028;- Numri i vlerësimeve profesionale për monitorimin dhe vlerësimin e punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë dhe raportet për të njëjtat për vitet 2026, 2027 dhe 2028.
Nënprogrami 6: Dokumentacioni dhe evideca pedagogjike, përmbajtje digjitale dhe kurse online	Tregues i suksesit për vitin 2026, 2027 dhe 2028: <ul style="list-style-type: none">- Formularë të përpiluar, të shtypur dhe të shpërndarë për arsimin fillor dhe të mesëm;- Materiale mësimore të botuara, udhëzues për mësimdhënësit dhe materiale të tjera didaktike;- Bibliotekë e pasuruar e Byrosë me literaturë profesionale;- Përgatitje rreth numrit të nxënësve dhe numrit të paraleleve sipas gjuhës së mësimin për shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut;- Formularë të përkthyer për arsimin fillor dhe të mesëm (në gjuhën shqipe, turke, serbe dhe boshnjake) me lekturë,



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

	<p>korrekturë dhe përpunim teknik;</p> <ul style="list-style-type: none">- Materiale mësimore të përkthyer, doracakë për mësimdhënësit dhe materiale të tjera didaktike;- Dokumente të përkthyer dhe të lekturuara të Byrosë në kuadër të korrespondencës zyrtare me shkrim;- Uebfaqe e përditësuar e Byrosë;- Numër i këshilltarëve të trajnuar nga njësi për zhvillimin e përmbajtjeve digjitale.
<p>Nënprogrami 7: Ndjekja dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve dhe mësimdhënësve</p>	<p>Tregues i suksesit për vitin 2026, 2027 dhe 2028:</p> <ul style="list-style-type: none">- Numri i kuadrit edukativo-arsimor të trajnuar për përgatitjet për studimin ndërkombëtar TIMSS për vitin 2027;- Numri i kuadrit edukativo-arsimor të trajnuar për përgatitjet për studimin ndërkombëtar PISA për vitin 2029.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

**B: Plani për zbatimin e programit:
 Arsim parashkollor, fillor dhe i mesëm cilësor**

Nënprograma 1: Standardet për arsimin parashkollor

Aktivitete	Përgjegjës	Të konsultuar	Kornizë kohore		Burime të nevojshme					
			Fillimi (muaji/viti)	Përfundimi (muaji/viti)	Njerëzore			Financiare (MKD)		
1. Hartimi i standardeve për mësimin dhe zhvillimin e hershëm	- Sektori për zhvillimin e sistemit arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore - Njësia për zhvillimin e sistemit arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin parashkollor dhe në mësimin klasor.	- MPSDR, - UKM, - fakultete pedagogjike, - UNICEF, - zyra e BE-së në RMV, - përfaqësues të kopshteve për fëmijë.	tremujori I 2026	tremujori IV 2026	viti I	viti II	viti III	viti I	viti II	viti III
					20			500.000		



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

<p>2. Hartimi i programit për të nxënit dhe zhvillimin e hershëm për fëmijët e moshës 0–6 vjeç</p>	<p>- Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore</p> <p>- Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe mësimin klasor</p>	<p>- MPSDR, - UKM, - fakultete pedagogjike, - UNICEF, - zyra e BE-së në RMV, - përfaqësues të kopshteve për fëmijë.</p>	<p>tremujori II 2026</p>	<p>tremujori IV 2026</p>	<p>20</p>			<p>500.000</p>		
<p>3. Rishikimi i evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik</p>	<p>- Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore</p> <p>- Njësia për zhvillimin e</p>	<p>- MPSDR, - UKM, - fakultete pedagogjike, - UNICEF, - zyra e BE-së në RMV, - përfaqësues të kopshteve për fëmijë.</p>	<p>tremujori I 2026</p>	<p>tremujori IV 2026</p>	<p>20</p>			<p>50.000</p>		



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

	sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe mësimin klasor									
4. Realizimi i trajnimeve për kuadrin edukativo-arsimor për zbatimin e standardeve, programit të ri për të nxënit e hershëm dhe zhvillimi dhe zbatimi i evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik të rishikuar	<ul style="list-style-type: none"> - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve mësimore... plane dhe programe - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe mësimin klasor 	<ul style="list-style-type: none"> - MPSDR - praktikues - profesorë universitarë 	tremujori I 2026	tremujori IV 2026	20			400.000		
5. Realizimi i trajnimeve	-Sektori për	- MPSDR,								



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

<p>për kuadrin edukativo-arsimor për përmirësimin e bashkëpunimit të çerdhes me prindërit dhe komunitetin</p>	<p>zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore -Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe mësimin klasor</p>	<p>- UKIM, fakultete pedagogjike, -UNICEF, -zyra e BE-së në RMV, -përfaqësues të kopshteve për fëmijë.</p>	<p>tremujori I 2026</p>	<p>tremujori IV 2028</p>	<p>15</p>	<p>15</p>	<p>15</p>	<p>300.000</p>	<p>300.000</p>	<p>300.000</p>
<p>6. Realizimi i trajnimeve për kuadrin edukativo-arsimor për tema të tjera të lidhura me procesin edukativo-arsimor</p>	<p>- Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor</p>	<p>- MPSDR, - UKIM, fakultete pedagogjike, - UNICEF, - zyra e BE-së në RMV, - përfaqësues të kopshteve për fëmijë.</p>	<p>tremujori I 2026</p>	<p>tremujori IV 2028</p>	<p>15</p>	<p>15</p>	<p>15</p>			



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

	dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe mësimin klasor									
7. Hartimi i dokumenteve të tjera të lidhura me edukimin dhe arsimin parashkollor	<ul style="list-style-type: none"> - Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe mësimin klasor. 	<ul style="list-style-type: none"> - MPSDR, - UKIM, - fakultete pedagogjike, - UNICEF, - zyra e BE-së në RMV, - përfaqësues të kopshteve për fëmijë. 	tremujori I 2026	tremujori IV 2028	15	15	15			
Gjithsej aktivitete në vitin I: 7					125					
Gjithsej aktivitete në vitin II: 3						45				



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Gjithsej aktivitete në vitin II: 3			45			
Gjithsej për nënprogramën 1: 13				1.750.000	300.000	300.000

Nënprograma 2: Standarde, plane dhe programe mësimore për arsimin fillor										
Aktivitet	Përgjegjës	Të konsultuar	Kornizë kohore		Burime të nevojshme					
			Fillimi (muaji/viti)	Përfundimi (muaji/viti)	Njerëzore			Financiare (MKD)		
1. Hartimi / rishikimi i planeve mësimore për klasën VIII (të tetë) dhe IX (të nëntë) të arsimit fillor	- Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor në arsimin fillor.	- sektorë të tjerë në BZHA, - bashkëpunëtorë të jashtëm	tremujori I 2026	tremujori IV 2026	viti I 40	viti II	viti III	viti I 500.000	viti II.	viti III.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

<p>2. Realizimi i trajnimeve për kuadrin edukativo-arsimor për zbatimin e planeve të reja mësimore për klasën VIII (e tetë) dhe IX (e nëntë) të arsimit fillor</p>	<p>- Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe mësimin klasor - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor në arsimin fillor.</p>	<p>- sektorë të tjerë në BZHA; - bashkëpunëtorë të jashtëm.</p>	<p>tremujori II 2026</p>	<p>tremujori III 2027</p>	<p>40</p>	<p>40</p>		<p>300.000</p>	<p>300.000</p>	
<p>3. Hartimi i dokumenteve</p>	<p>- Sektori për</p>	<p>- sektorë të tjerë</p>								



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

të tjera të lidhura me arsimin fillor	zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe mësimin klasor - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor në arsimin fillor	në BZHA, -bashkëpunëtoë të jashtëm	tremujori I 2026	tremujori IV 2028	30	30	30			
4. Realizimi i trajnimeve për kuadrin edukativo-	- Sektori për zhvillimin e	- sektorë të tjerë në BZHA,	tremujori I	tremujori IV	30	30	30			



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

arsimor për tema të tjera të lidhura me procesin edukativo-arsimor	sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në edukimin parashkollor dhe mësimin klasor - Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në mësimin lëndor në arsimin fillor.	-bashkëpunëtorë të jashtëm	2026	2028						
					140					
Aktivitete të përgjithshme në vitin I: 4						100				
Aktivitete të përgjithshme në vitin II: 3						60				
Aktivitete të përgjithshme në vitin III: 2										



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Gjithsej për nënprogramin 2: 9				800.000	300.000	
--------------------------------	--	--	--	---------	---------	--

Nënprograma 3: Standarde, plane dhe programe mësimore për arsimin e mesëm (gjimnaz, arsim artistik, gjimnaz sportiv, akademi sportive, arsim profesional të mesëm, arsim i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe gjimnaz matematikor-informatik)

Aktivitete	Përgjegjës	Të konsultuar	Kornizë kohore		Burime të nevojshme					
			Fillimi (muaji/viti)	Përfundimi (muaji/viti)	Njerëzore			Financiare (MKD)		
1. Hartimi i planeve të reja mësimore për arsimin e mesëm gjimnazial	Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programe mësimore në arsimin gjimnazial, lëndët e arsimit të përgjithshëm	- sektorë të tjerë në BZHA, - bashkëpunëtorë të jashtëm	tremujori I 2026	tremujori IV 2028	Viti I 100	Viti II 100	Viti III 100	Viti I 1.900.000	II vit. 3.000.000	III vit. 3.000.000



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

	në arsimin profesional dhe arsimin artistik.									
2. Realizimi i trajnimeve për kuadrin edukativo-arsimor për zbatimin e programeve të reja mësimore për arsimin e mesëm gjimnazial	Sektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin gjimnazial, lëndët e arsimit të përgjithshëm në arsimin profesional dhe arsimin artistik.	-sektorë të tjerë në BZH, -bashkëpunëtorë të jashtëm	tremujori i dytë 2026	tremujori i tretë 2028	15	15	15	600.000	900.000	900.000
3. Hartimi i një Koncepti të ri për arsimin e mesëm artistik	Sektori për zhvillimin e sistemit	- sektorë të tjerë në BZHA; -bashkëpunëtorë të	tremujori I 2026	tremujori IV 2026	10			100.000		



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

	edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore Njësia për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore në arsimin gjimnazial, lëndët e arsimit të përgjithshëm në arsimin profesional dhe arsimin artistik.	jashtëm.								
4. Hartimi i planeve të reja mësimore për arsimin e mesëm artistik	Spektori për zhvillimin e sistemit edukativo-arsimor dhe zhvillimin e standardeve, planeve dhe programeve	- sektorë të tjerë në BZHA; -bashkëpunëtorë të jashtëm.	tremujori I 2027	tremujori IV 2028		200	200		2.000.000	2.000.000



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
 Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
 Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

